

KES Publikimet

PUNA

&

PUNËSIMI



Raporti 1  
2016

# **PËRMBATJA**

## **HISTORIKU & METODOLOGJIA – fq.1**

Projekti – fq.1

Objektivat – fq.1

Qasja dhe metodologjia – fq.2

Mostra e anketimit dhe metodologjia e mostrës - fq.2

## **GJETJET – fq.4**

Punësimi – fq.4

Papunësia – fq.6

## **KONKLuzionET & REKOMANDIMET – fq.13**

Konkluzionet kryesore – fq.13

Rekomandimet kryesore – fq.14

Ky raport është përgatitur në bashkëpunim me stafin e MPMS-së dhe përmbajtja e saj pasqyron kontributet e përbashkëta të kontraktorit dhe homologëve e të saj të ministrisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e projektit për mbështetje të Partnerëve Social të menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe e implementuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), sipas kërkesës të së cilës ky hulumtim është kryer.

# HISTORIKU & METODOLOGJIA

## Projekti

Ky raport është pjesë e aktiviteteve të cilat janë planifikuar për implementimin e projektit “Përkrahje Partnerëve Social” (PPS) i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Projekti kontribuon në, zhvillimin e aftësive dhe njohurive të partnerëve social, hartimin e legjislacionit-hulumtimeve ligjore dhe analizave, forcimin e kapaciteteve administrative dhe menaxhuese të partnerëve social, forcimin e kapaciteteve të partnerëve social në avokim, lobim dhe negociata si dhe në lehtësimin e reformave organizative të partnerëve social.

Raporti është një përkrahje e drejtpërdrejtë në punën e Këshillit Ekonomik dhe Social (KES), i cili me ligj është përgjegjës për lehtësimin e dialogut trepalësh social në vend. Ky raport, që është kontribut i projektit PPS, ofron informacione të mbledhura në terren të cilat janë diskutuar në KES. Mbështetje aktive i është dhënë Sekretariatit të KES-it, e cila e kombinuar me digjitalizimin e materialeve të KES-së, ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të procesit në kuadër të këtij organi.

Projekti është në harmoni me proceset duke marrë parasysh të gjitha ngjarjet e mëdha dhe programet që po ndodhin gjatë periudhës së zbatimit. Qasja e harmonizimit të të gjitha aktiviteteve të projektit, në proceset e vazhdueshme të akterëve shihet si më e përshtatshme për marrjen e rezultateve më cilësore. Disa nga aktivitetet e projektit janë të varura nga proceset dhe bashkëpunimet e akterëve të cilat nuk mund të zbatohen pa pjesëmarrjen e tyre.

## Objektivat

Qëllimi i kësaj ankete me popullsinë e përgjithshme vlerësohet si në vijim:

- Niveli i ndërgjegjësimit publik dhe njohurive mbi politikat sociale;
- Niveli i opinionit publik, qëndrimin ndaj sistemeve të mirëqenies dhe nivelin e mbrojtjes së dëshiruar nga ana e qytetarëve;
- Qëndrim publik ndaj emigrimit të paligjshëm;
- Pritjet dhe qëndrimet e publikut të gjerë drejt politikave sociale dhe të punësimit;
- Shprehitë individuale të kursimeve dhe qëndrimet e publikut të gjerë.

Gjetjet në këtë hulumtim janë reagime të qytetarëve dhe janë të besueshme për t'u përdorur për vendimmarrje. Këto gjetje, përdoren nga anëtarët e Këshillit Ekonomik Social dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Për këtë arsye, audienca e këtij raporti, janë: përfaqësuesit e institucioneve, organizatat donatore ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës, partitë politike, Organizatat e Shoqërisë Civile, mediat, si dhe publiku i gjerë.

Duke pasur parasysh mungesën e literaturës dhe hulumtimeve lidhur me temat e këtij raporti, informacionet e paraqitura këtu mund të përdoren edhe nga studentët dhe akademikët në punën e tyre.

## Qasja dhe metodologjia

Qasja në këtë temë është bërë përmes intervistave të strukturuar, ballë-për-ballë me një mostër prej 1,100 të të anketuarve në tërë Kosovën, e cila është shpërndarë me metodën proporcionale e që pasqyron të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë. Mostra prej 1,100 e të anketuarve, është caktuar në 100 vendbanime/fshatra në tërë Kosovën, të cilat janë përzgjedhur nga regjistri i vendvotimeve në Kosovë. Përzgjedhja është bërë në mënyrë të rastësishme. Është përzgjedhur çdo e njëzeta qendër e votimit/ vendbanimit në listë si dhe duke përdorur metodën në çdo të tretën shtëpi.

## Mostra e anketimit dhe metodologjia e mostrës

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), ka dhënë instrumentin pyetësor ndërsa, AnketaCo, ka përkthyer dhe testuar instrumentin/pyetësorin para formës përfundimtare. Pasi që pyetësi i testuar u finalizua, ai më pas është konsideruar si instrument hulumtues i miratuar për kryerjen e studimit.

Metodologjia e propozuar ka prodhuar një mostër që është besnike ndaj realitetit në terren, pasi që përzgjedhja e të intervistuarve dhe vendbanimeve është bërë në mënyrë të

rastësishme. Si rezultat i kësaj, mostra është normalizuar vetë dhe ka karakteristikat e mëposhtme. Sa i përket karakteristikave demografike të të anketuarve, në bazë të statistikave zyrtare të regjistrimit, 66 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se janë të martuar ndërsa 29 për qind e tyre kanë deklaruar se janë beqarë. Statuset tjera sociale janë me përqindje më të ulëta. Në aspektin e madhësisë së familjeve, grupi më i madh në mostër deklaruan se kanë 3 deri në 5 anëtarë (47.9 të anketuarve), pasuar me ato familje që kanë nga 6 deri në 10 anëtarë (42.9 për qind). Kurse, familjet më të vogla (1-2 anëtarë) dhe ato më të mëdha (mbi 11 anëtarë) janë të përfaqësuara me përqindje më të vogla (4.6 për qind dhe 4.8 për qind). Në pyetjen në lidhje me numrin e anëtarëve të punësuar në familje, shumica e të anketuarve kanë raportuar 1-2 anëtar të punësuar. Gjendjes sociale dhe ekonomike e të anketuarve në mostër, është një reflektim i situatës që konsiderohet se mbizotëron në këtë terren. Në këtë drejtim, 17.7 për qind e të anketuarve kanë të ardhura të përbashkëta familjare prej më pak se 100 euro në muaj. 30.6 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se të ardhurat mujore familjare të tyre janë 100 deri në 300 euro në muaj, ndërsa 28 për qind kanë deklaruar se kanë të ardhura prej 301 deri në 500 euro në muaj. 12.4 për qind




Figura 1. Karakteristikat e mostrës

e të anketuarve kanë të ardhura mes 501 dhe 800 euro në muaj. Vetëm 5.5 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore mes 801 dhe 1000 euro në muaj dhe vetëm 3.1 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të ardhura familjare prej mbi 1000 euro në muaj.

Vetëm 10 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë 3 deri në 5 anëtarë të familjes të punësuar, ndërsa 25 për qind e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë asnjë anëtarë të familjes të punësuar. Figura 2 paraqet një pasqyrë të plotë vizuale të këtyre tri karakteristikave demografike të mostrës.

prindërve. 8.8 për qind e të anketuarve në mostër jetojnë në banesa, ndërsa 4.5 për qind e tyre jetojnë në apartamente/shtëpi me qëra. Lidhur me nivelin e arsimit e të anketuarve, grupi më i madh në mostër janë ata me arsim të mesëm (50 për qind), pasuar nga ata me arsim fillor (23.7 për qind), ndjekur nga ata me shkollë fillore (23.7 për qind), dhe të diplomuarit në nivelin bachelor (17.1 për qind). Figura 3 jep një pasqyrë të të ardhurave të anketuarve, kushtet e jetesës dhe arsimin në detaje.




Figura 2. Karakteristikat demografike të anketuarëve

Situata e kushteve të jetesës në këtë mostër tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve jetojnë në shtëpi të cilat janë pronë e tyre (64.3 për qind), e ndjekur nga 21.7 për qind e të anketuarve të cilët jetojnë në shtëpi të




Figura 3. Të ardhurat, edukimi dhe kushtet e banimit

# GJETJET

## Punësimi


Kjo pjesë e raportit paraqet gjendjen e punësimit, llojin e punësimit dhe aspektet tjera të angazhimit në tregun e punës. Po ashtu, kjo pjesë mbulon edhe kualifikimet e të anketuarve si dhe mjetet që ata kanë përdorur për të gjetur punë.

Gjendja e tregut të punës si dhe periudha e përfundimit të studimeve të të anketuarve është konsideruar si informacion thelbësorë. Siç mund të shihet në figurën 4 më poshtë, grupi më i madh i mostrës është i përfaqësuar nga papunësia afatgjate, e cila po ashtu është lloji më problematik i papunësisë. Grupi i dytë më i madh në mostër është të punësuarit afatgjatë, e cila përfaqëson vetëm një pjesë të mostrës së përgjithshme (14.5 për qind). Kategoria e tretë më e madhe në mostër është vetë-punësimi (12 për qind) ndërsa në vendin e katërt radhiten të pensionuarit (6.5 për qind). Sa i përket vitit kur kanë përfunduar nivelin më të lartë të arsimit, 37.8 për qind e të anketuarve thonë se nuk e kanë bërë në periudhën 2001-2015. Ndërsa, ata që e kanë përfunduar vitin e fundit të arsimit në periudhën 1981-2000 përfaqësojnë grupin e dytë më të madh në mostër me 24.7 për qind të totalit. Kur analizohet në bazë gjinore, punësimi tek femrat është raportuar në nivele më të ulëta.

Në këtë drejtim femrat përbëjnë 57 për qind të numrit të përgjithshëm të të papunëve, ndërsa meshkujt (edhe pse përfaqësojnë numër më të madh në mostër) përbëjnë 43 për qind. Një numër i madh ka të bëjë me statusin e vetë-punësimit. Femrat përbëjnë vetëm 18 për qind të numrit të përgjithshëm të vetë-punësuarave në mostër. Dallim i madh në mes meshkujve dhe femrave mund të shihet edhe në lidhje me rekrutimin afatgjatë, ku meshkujt përbëjnë 60 për qind të totalit të këtij nën-grupi ndërsa femrat përfaqësojnë më pak se 40 për qind. Analiza e përgjigjeve sipas grup moshave të të anketuarave tregon se 60 për qind e të anketuarave në kategorinë e të papunësuarve janë nën moshën 41 vjeç, pjesa tjetër prej 41.5 për qind i përkasin grup moshës 41 deri 50 vjeç. Sa i përket kategorisë së punësimit afatgjatë, 15 për qind e të anketuarve në këtë grup janë prej 18 deri në 25 vjeç, 40.3 për qind e tyre i përkasin moshës 26 deri 41 vjeç dhe 47 për qind të cilët i përkasin moshës prej 41 deri në 65 vjeç. Një pasqyrë e plotë e rezultateve që kanë të bëjnë me pyetjen në lidhje me përfundimin e nivelit më të lartë të edukimit dhe arsimit është e paraqitur në figurën 4.

Për aspektet tjera që lidhen me llojin e punës të raportuar nga të intervistuarit në mostër, 23.6 për qind e të anketuarve raportojnë se

Viti i përfundimit të shkollimit formal



Gjendja e punësimit aktuale




Figura 4. Viti i përfundimit të shkollimit dhe statusi i punësimit

ata janë të punësuar në sektorin privat, 7.6 për qind në sektorin publik, ndërkohë që 67.7 për qind raportojnë status jo-aktiv (në pension, student, etj). Vetëm 1 për qind e të anketuarve thonë se punojnë në OJQ vendore e ndërkombëtare.

Kohëzgjatja e punësimit në vendin aktual të punës është një tjetër aspekt që anketa e ka mbuluar. Përsëri, shumica e të anketuarve (65 për qind) kanë raportuar se ata nuk janë të punësuar në mënyrë aktive. Nga ata që raportojnë marrëdhënie pune afatgjate, me më shumë se 5 vjet (17 për qind e totalit të mostrës). Grupi i dytë më i madh është ai nga të cilët raportuan nga 2-5 vjet në vendin aktual të punës (5.8 për qind), pasuar nga ata që në vendin aktual të punës janë prej 1 deri në 2 vite. Të punësuarit gjatë vitit të kaluar përbëjnë 7.1 për qind të numrit të përgjithshëm të hulumtimit me një përqindje pothuajse të barabartë me atë të punësuarve në 6 muajt e kaluar dhe ata që punojnë nga 6 muajt dhe 1 vit.

Analiza tregon se vetëm 28.5 për qind e grave kanë raportuar punësimin në sektorin privat ndërsa, 71.5 për qind është numri i meshkujve të punësuar në këtë sektor. Punësimi në sektorin publik nga baza gjinore

është i balancuar me 52 për qind të këtij grupi që janë meshkuj dhe 48 për qind femra.

Në aspektin e moshës, lloji më i shpeshtë i raportuar për punësimin janë moshat 18-25 vjeç (25 për qind) e numrit të përgjithshëm të




Figura 5. Lloji dhe kohëzgjatja e punësimit

të anketuarve, në sektorin privat. Pastaj, OJQ-të lokale me 14.3 për qind dhe sektori publik i llogaritur me më shumë se 3 për




Figura 6. Si keni gjetur punë dhe lloji i kontratës

qind. Grup mosha 25 - 40 vjeç dhe 41 - 65 vjeçare janë 38 për qind dhe 33 për qind.

Kur analizojmë përgjigjet e të anketuarve në baza gjinore, përsëri shohim se femrat janë në disavantazh në krahasim me meshkujt në aspektin e kohëzgjatjes së punësimit të tyre. 71.7 për qind e meshkujve thonë se kanë më shumë se pesë vjet në të njëjtën punë/pozicion dhe 73.4 për qind e tyre që punojnë në të njëjtin vend pune në mes të 2 dhe 5 vjet. Përgjigja më e balancuar lidhet me periudhën e shkurtër të punës, ku femrat duket se janë përfaqësuar në mënyrë më adekuate (42% të punësuarra më pak se 6 muaj ishin femrat, dhe 45 e atyre që janë të punësuar për 6 muaj - 1 vit).

Përmes reklamave dhe publikimeve në gazetata lokale është mënyra me të cilën 14 për qind e të anketuarve kanë gjetur punë. Ndërkaq, përmes pjesëmarrjes në intervistë apo testim kanë gjetur punë 3.1 për qind. 3 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë gjetur punë përmes qendrës publike për punësim ndërsa, një përqindje e ngjashme (2.9 për qind) tregojnë se miqtë dhe familjet e tyre ua kanë siguruar pozitat e tanishme.

Një pyetje tjetër për të cilën është hulumtuar ka të bëjë më shqetësimet në lidhje me llojet e kontratave me të cilat janë të pajisur të punësuarit. 9.7 për qind e të anketuarve në raport kanë deklaruar se janë të punësuar pa kontratë. 17.9 për qind kanë deklaruar se janë të punësuar me kontratë të rregullt dhe që kontributet e tyre janë të mbuluara nga punëdhënësit e tyre. Ndërsa, më pak se 1 për qind e të anketuarve thonë se kanë një kontratë të rregullt, por që pagat i marrin me para kesh në dorë. Kjo përbërje e të anketuarve tregon llojin më problematik

informal (dhe më të përhapur në të njëjtën kohë), i cili është një informalitet i plotë. Të dhënat e anketës po ashtu tregojnë se në rastet ku të punësuarit kanë kontrata, disa punëdhënësit i nënshtrohen informalitetit të pjesshëm. Ndërsa, në qoftë se janë të punësuar formalisht me kontratë të rregullt, në shumicën e rasteve, kontributet janë të paguara në mënyrë të plotë dhe të rregullt.

## **Papunësia**

Kjo pjesë e raportit mbulon karakteristikat kryesore të papunësisë dhe parashikon disa nga paradigmat themelore dhe aspektet strukturore të fenomenit të papunësisë. Kjo mbulon gjatësinë e papunësisë, pritjet për kompensim/pagë, llojin e punës që kërkohet, veprimet që janë duke u marrë për të gjetur një punë si dhe aspektet e lidhura me perceptimin e shërbimeve publike të punësimit. Pjesa më e madhe e të anketuarve (38.9 për qind) raportojnë se i përkasin grupit më problematik të të papunëve, pra të papunët afatgjatë. Ata që kanë qenë të papunë në mes 3-5 vjet përfaqësojnë 5.2 për qind e të anketuarve në mostër, ndërsa ata që kanë qenë të papunë për 1-2 vjet dhe 6 muaj deri në 1 vit janë të përfaqësuar me nga 3.5 për qind të mostrës në total. Vetëm 1.2 për qind e të anketuarve në mostër kanë qenë të papunë për më pak se 6 muaj.


Kur shikohet në baza gjinore, femrat krahasim me meshkujt bëjnë pjesë në kategorinë e papunësisë afatgjatë.

58 për qind e femrave janë të papunësuarra për më shumë se pesë vjet. Ndërsa, 59 për qind janë të papunësuarra mes 2 deri në 5 vjet. Kategoritë e papunësisë afat-shkurtër janë më të balancuara, por megjithatë, femrat përbëjnë më shumë se 50 për qind në secilën kategori



e cila në mënyrë të konsiderueshme tregon një nivel më të lartë të papunësisë femërore.

Të intervistuarit u pyetën edhe për pagën minimale për të cilën do të ishin të gatshëm për të punuar me orar të plotë. Grupi më i madh në mostër (20.7 për qind) raportuan gatishmëri për të punuar për 250-300 euro pagë mujore me orar të plotë. Grupi i dytë (13.7 për qind) deklaruan se janë të gatshëm për të punuar për 201-250 euro në muaj me orar të plotë. Pjesa tjetër deklaruan se janë të gatshëm të punojnë për 301-400 euro në muaj (10.6 për qind). Ndërsa, 6.1 për qind janë shprehur të gatshëm për të punuar me orar të plotë për 151-200 euro pagesë mujore. Një përqindje e vogël prej 2.3 për qind thonë se do të punonin edhe për më pak se 150 euro. Duke pasur parasysh nivelin e varfërisë të regjistruar në tërë Kosovën, kjo përgjigje nuk është befasuese. Figura 7 më poshtë paraqet rezultatet vizuale të inspektimit në lidhje me llojin e papunësisë që aktualisht mbizotëron në terren si dhe kompensimin e pritshëm nga të papunët për punë me orar të plotë.



Gatishmëria për të punuar dhe niveli i pritshëm i pagave duket të jenë të njëanshme sa i përket gjinisë. Burrat në mostër përfaqësojnë shumicën e përgjigjeve (64 për qind) të cilët do të ishin të gatshëm të punojnë për më pak se 150 euro në muaj.

Përderisa, kategoria që është e gatshëm për të punuar për 151-200 euro në muaj është e balancuar në nivel gjinor, niveli i pagave 201-250 euro është i dominuar nga femrat (66 për qind e kësaj kategorie). Një situatë e ngjashme vihet re në lidhje me pagat e nivelit 251-300 euro dhe 301-400 euro në muaj, ku gratë janë përfaqësuar me 58 për qind dhe 54 për qind respektivisht. Nivelet e pagës 401-500 euro në muaj janë të dominuara nga meshkujt (64 për qind), ndërsa pagat përtej kësaj vlere janë më neutrale në përfaqësim.

Në lidhje me llojin e punës që të papunët do të dëshironin të kryenin si dhe në lidhje me praktikatat e tyre për të kërkuar punë të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje.

39.7 për qind kanë deklaruar se preferenca e tyre është puna me orar të plotë, pasuar nga ata që preferojnë vetë-punësim (7.5 për qind) dhe punë me orar të shkurt (7.4 për qind). Duhet theksuar se 43.9 për qind e të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje dhe kjo potencialisht tregon se ata nuk





Figura 7. Kohëzgjatja e punësimit dhe paga minimale e pritshme

e dinë se çfarë janë preferencat e tyre, apo më keq, nuk kanë tendencë për tu angazhuar në tregun e punës. Një përqindje e vogël prej vetëm 1.4 për qind kanë deklaruar se janë të interesuar në mundësitë e punësimit afatshkurtër.

Kur shihet në bazë gjinore, duket se preferencat për llojin e punësimit tek femrat janë shumë më ndryshe nga ato të meshkujve. Femrat duket të jenë të prirura për të dashur një punë me orar të shkurt (ato përbëjnë 72,8 për qind të këtij grupi), me orar të plotë (55 për qind e kategorisë në total) dhe punë të përkohshme (60 për qind e totalit të anketuarve). Nga ana tjetër, vetëpunësimi duket se është i padëshiruar për femrat si alternativë dhe vetëm 37 për qind e femrave janë deklaruar se e pëlqejnë vetëpunësimin.



Preferencat e të anketuarve për llojin e punës janë të pritshme, pasi që siguria e punës me orar të plotë është dëshirë e natyrshme e të papunëve. Megjithatë, praktikat për të kërkuar një punë e cila do të iu përshtatet preferencave është e pamjaftueshme. Një përqindje tronditëse prej 34.9 për qind e të anketuarve në mostër nuk kanë aplikuar për ndonjë pozitë gjatë vitit të kaluar. Vetëm, 15.6 për qind kanë deklaruar se kanë aplikuar në 1 deri në 5 pozita. Ndërsa, 5.5 për qind kanë kërkuar punësim në 6 deri në 10 pozita, 2.5 për qind e të anketuarve deklaruan se kanë aplikuar në 11 deri në 20 pozita. Ndërkaq vetëm 1.1 për qind thanë se kanë aplikuar në më shumë se 20 vende pune.

Në aspektin e gjinisë, femrat duket se janë më pasive se burrat në kërkimin aktiv të punës. 63 për qind e të anketuarve të cilët raportuan se kanë aplikuar për 10 deri në 20 vende pune në vitin e fundit janë meshkuj. Po ashtu, 75 për qind e meshkujve kanë aplikuar në më shumë se 20 pozita. Figura 8 tregon përgjigjet në këto dy aspekte. Kur u pyetën për arsyet pse të anketuarit mendojnë se nuk mund të gjejnë punë, 25.2 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se ata nuk kanë miq në pozita të rëndësishme si





Figura 8. Mënyrat e kërkimit të punës dhe punën e preferuar

arsye kryesore për papunësinë e tyre.

Ndërkaq, rezultatet e hulumtimit tregojnë se vetëm 2.9 për qind e të anketuarve që janë të punësuar aktualisht janë marrë në punë me ndihmën e miqve apo familjarëve, është e qartë se ekziston një keqkuptim në mesin e atyre që kërkojnë punë. 9.5 për qind e të anketuarve nuk i din arsyet pse ata nuk mund të gjejnë një punë. Kurse, 7.8 për qind besojnë se mungesa e kërkesës për profilet e tyre është arsyeja e papunësisë së tyre. Një tjetër numër prej 7.2 për qind thonë se nuk i kanë aftësitë e kërkuara në tregun e punës, ndërkohë që vetëm, 5 për qind e tyre thonë se nuk kanë gjetur punë në profesionet e tyre.

(Nëse i papunë) Sipas jush, cila është arsyeja kryesore për mos gjetjen e një vend pune?



(Nëse i papunë) A keni marrë pjesë në trajnimet e ofruara nga QTP?




Figura 9. Arsyet kryesore të papunësisë dhe pjesëmarrja në trajnime

Pavarësisht pranimit të mungesës së aftësive për të konkurruar në tregun e punës si dhe mungesës së kërkesës në profesionet e tyre për të cilat kanë deklaruar se nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë punë, vetëm 10.4 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në trajnimet e QAP. 46.5 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë marrë pjesë në këto trajnime, ndërsa 43.2 për qind nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Nëse analizohen në aspektin e gjinisë, kjo tregon se më shumë femra se meshkuj kanë konfirmuar se kanë marrë pjesë në këto trajnime (51.8 për qind të numrit të përgjithshëm të të anketuarve apo 59 gra, në krahasim me 55 burra apo 48.1 për qind e tyre). Sa i përket shpërndarjes së përgjigjeve sipas grup moshave, të anketuarit e moshës 25-41 vjet përfaqësojnë grupin më të madh që kanë konfirmuar pjesëmarrjen në Qendrat e Aftësisimit Profesional (QAP), 48.2 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje. Grupi i dytë më i madh i përgjigjeve pozitive janë brenda moshës 18-25 me 30.7 për qind të numrit të përgjithshëm të të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht.

Në grupin e atyre që raportojnë se ata nuk kanë qenë pjesë e trajnimeve të ofruara falas nga shërbimet publike për punësim, 12.9 për qind e të anketuarve thanë se nuk kanë ditur për këtë shërbim. 4.5 për qind e tyre thanë se ata nuk ishin të interesuar për të marrë pjesë në këto trajnime, ndërsa 2.9 për qind e të intervistuarve raportuan se nuk iu është dhënë mundësia, ose nuk kanë kohë për të marrë pjesë. Ndërkaq, vetëm 2.9 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk ishin të informuar për këto trajnime. Figura 10 jep një pasqyrë të përgjigjeve të ndryshme të të anketuarve.

Nëse JO, përse nuk keni marrë pjesë në trajnime?



Figura 10. Arsyet për mos pjesëmarrje në trajnime

Praktika të tjera të zakonshme të kërkimit të punës kanë qenë përmes reklamave në gazeta si dhe përmes ndihmës së miqve apo familjarëve. Në lidhje me opsionin e parë, 13.9 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se reklamat janë ato përmes së cilave bëjnë




Figura 11. Praktikata e kërkimit të punës

përpjekje për të gjetur një punë. Ndërsa, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (22.8 për qind ) e kanë konfirmuar se hallin e tyre për të gjetur një punë e kanë ndarë me miqtë, familjen dhe sindikatat. Veprimet që janë ndërmarr për të gjetur punë janë shtjelluar në këtë studim ku më pas janë mbledhur edhe përgjigjet. Të anketuarit janë përgjigjur pozitivisht në tri format/kanalet më të zakonshme të kërkimit të punës. 15 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se veprimet që kanë ndërmarrë për të gjetur një vend pune kanë qenë vizitat në qendrat për punësim, ndërkohë, që kërkimi i drejtpërdrejtë për punë tek punëdhënësit është metoda më e zakonshme e kërkimit për punë. 21.5 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve kanë konfirmuar se kanë zbatuar atë në përpjekjet për të gjetur punë. Agjencitë private të punësimit kanë qenë metoda e

preferuar për të gjetur punë për 17 për qind të të anketuarve.

Rezultatet tregojnë se femrat janë më agresive për të kërkuar punë krahasim me meshkujt të cilët kanë vetëm një kanal në kërkim të vendit të punës. Pra, 53.4 për qind e meshkujve opsionin e vetëm për të gjetur punë e shohin duke iu thënë miqve dhe familjes.

Në anën tjetër, femrat tregojnë pasivitet më të lartë në kërkim të punës.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm duke pasur parasysh karakteristikat e papunësisë është gatishmëria dhe disponueshmëria për të punuar menjëherë (në të ardhmen e afërt). Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.3 për qind) të mostrës kanë konfirmuar se janë në




Figura 12. Aplikimi përmes shpalljeve në gazete dhe familjes si dhe gatishmëria për punë

gjendje për të filluar punën menjëherë. Ndërsa, 42.7 për qind nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Vetëm 9 për qind e të anketuarve në mostër thonë se nuk mund të punojnë menjëherë në qoftë se atyre u ofrohet një mundësi e tillë.

Kur janë pyetur për arsyet se pse ata nuk do të ishin në gjendje që të punojnë menjëherë nëse u ofrohet punë, 2.2 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve u përgjigjën se ata kanë nevojë të përfundojnë studimet/trajnimet e tyre. 3 për qind e tyre kanë deklaruar se nuk mund të fillojnë të punojnë për shkak të përgjegjësiave personale/familjare, ndërsa 2.8 për qind deklarojnë sëmundje ose paaftësi si arsye pse nuk janë në gjendje të punojnë menjëherë në qoftë se atyre u ofrohet mundësia.

Rezultatet e marra në lidhje me këtë tregojnë se më shumë femra se meshkuj konfirmojnë gatishmërinë e tyre që të fillojnë menjëherë punën si dhe pamundësinë e tyre për të filluar punën për arsye të ndryshme. Kjo për arsye sepse shumica e meshkujve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje (67 për qind), e cila shtrembëron rezultatin. Megjithatë, duhet theksuar se në numra, 64 femra në krahasim me 35 meshkuj kanë deklaruar se nuk mund të fillojnë punën menjëherë, nëse atyre u ofrohet një mundësi e tillë. Duke

pasur parasysh se raporti meshkuj-femra në mostër është 55-45 për qind në favor të meshkujve, 64 për qind e femrave përfaqësojnë 12.6 për qind të të gjitha femrave në studim, ndërsa 35 meshkuj përfaqësojnë 6 për qind të numrit të përgjithshëm të meshkujve.

Një tjetër aspekt që është studiuar është nëse familjet e të anketuarve marrin ndihmë sociale. 14.4 për qind e të anketuarve në mostër i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje. Ndërkohë, që 46.7 për qind e përgjigjeve ishin negative. 36.5 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje, ndërsa 2.5 për qind kanë refuzuar të përgjigjen. Një rishikim i plotë i këtyre dy aspekteve është treguar në Figurën 13.

Aspektet e fundit në lidhje me pritjet e punësimit si dhe preferencat e përfshira në anketë janë ato që kanë të bëjnë me aftësitë/atributet e nevojshme për të gjetur një punë në sektorin privat dhe publik në Kosovë, dhe nëse ata preferojnë të punojnë në Kosovë apo jashtë vendit. Përqindja më e madhe e të anketuarve (47.6 për qind) kanë thënë se për të gjetur punë në sektorin publik, është e nevojshme që të kenë një lidhje, ndërsa 21.5 për qind e të intervistuarve





Figura 13. Arsyet e pamundësisë për të punuar dhe mos marrjës së asistencës sociale

Sipas mendimit tuaj, për të gjetur punë në sektorin privat në Kosovë ju duhet të:



Sipas mendimit tuaj, për të gjetur punë në sektorin publik në Kosovë ju duhet të:



Nëse do të mund të zgjidhni, ku do të punonit, në Kosovë apo Evrope?




Figura 14. Aftësitë e domosdoshme për të gjetur punë dhe preferencat mbi shtetin ku dëshiron të punoni?

deklaruan se duhet të kenë aftësitë dhe lidhjet për të gjetur një punë në Kosovë. 18 për qind e të anketuarve besojnë se për të marrë një punë në sektorin publik, është e nevojshme që të paguajnë rryshfet, ndërkohë që 11.4 për qind besojnë se të qenit kompetent nuk është e mjaftueshme për të marrë një punë në sektorin publik.

Kur u pyetën në lidhje me punësimin në sektorin privat, një përqindje më e lartë se në sektorin publik (54.9 për qind) besojnë se çelësi për të gjetur një punë është përmes lidhjeve. 22.7 për qind e të anketuarve (1.2 për qind më shumë se sa i përket sektorit publik) theksuan se vendet e punës në sektorin privat kërkojnë aftësi dhe lidhje në të njëjtën kohë. Ndërsa 13.2% e të anketuarve (1.8 për qind më shumë se në sektorin publik) besojnë se kompetencat dhe kualifikimet janë të mjaftueshme për të gjetur një punë në sektorin privat. 8.3 për qind e të anketuarve besojnë se edhe në sektorin privat duhet paguar rryshfet për të marrë një punë. Në lidhje me vendndodhjen e preferuar të punësimit, një përqindje befasuese prej 60.2 për qind e të anketuarve preferojnë të gjejnë një punë brenda Kosovës, ndërsa vetëm 22.5 për qind e tyre kanë treguar preferencën e tyre për të punuar në ndonjë vend tjetër Evropian. Gati 10 për qind thanë se nuk e

dinë nëse më parë do të punonin në Kosovë apo jashtë vendit. Rezultatet në aspektin e fundit (vendndodhja e preferuar e punës) janë një dukuri mjaft interesante për shkak se ato japin rezultate të papritura. Duke pasur parasysh trendët e migrimit drejt vendeve të BE-së në vitin e kaluar, preferencat drejt vendeve të BE-së si vende të punës janë çuditërisht të ulëta. Figura 14 jep një pasqyrë të rezultateve në lidhje me atributet e nevojshme për punësim në sektorin privat dhe publik si dhe preferencat e të anketuarve për lokacionin e vendit të punës. Sa i përket shpërndarjes së përgjigjeve sipas grup moshave, në secilën grup moshë Kosova është zgjedhja e preferuar për numrin më të madh të të anketuarve. Në kuadër të kësaj zgjedhje mbi 60 për qind e të anketuarve, 18.4 për qind ishin të grup moshës 18-25 vjeç, 40.8 për qind e tyre kanë qenë në grup moshën 21-40 vjet dhe 37.2 për qind në grup moshën 41-65 vjet. Megjithatë, mundësia për të punuar jashtë vendit duket të jetë tepër e dëshiruar për moshat më të reja në anketë, që ka regjistruar mbështetje mbi 15 për qind më shumë (33,9 për qind të përgjigjeve të përgjithshme) se sa grup moshat e mësipërme. Megjithatë, duhet theksuar se edhe në këtë grup moshë ka më shumë të anketuar të cilët më parë do të punonin në Kosovë se sa jashtë shtetit.

# KONKLUZIONET & REKOMANDIMET

## Konkluzionet kryesore

Studimi ofron disa gjetje shqetësuese të cilat duhet të marrin vëmendje të menjëhershme nga institucionet, ndërsa në të njëjtën kohë, ofron disa konkluzione të papritura që dalin nga rezultatet e këtij studimi.

Punësimi në Kosovë është në favor të meshkujve, të cilët përveç se janë të shfaqur me një prani më të madhe në fuqinë punëtore, po ashtu konsiderohen edhe më të sigurt në vendin e punës dhe në këtë mënyrë dominojnë në pozitat me punët afatgjate.

Punësimi joformal është ende i pranishëm në tregun e punës, po ashtu edhe mungesa e një kontrate të punësimit është e pranishme. Mungesa e kapacitetve të institucioneve përkatëse për zbatimin e legjislacionit të punës është konsideruar të jetë shkaku kryesor për rreth 10 për qind të të anketuarve të cilët kanë raportuar që punojnë në treg jo formal. Edhe në rastet kur ekzistojnë kontratat procedimi i rasteve gjyqësore që përfshijnë shkeljet e të drejtave të punës e bëjnë praktikisht të pamundur ndjekjen e rrugëve ligjore për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve të punës.

Numri më i madh i të punësuarve është në sektorin privat. 23.6 për qind e të anketuarve në raportin e mostrës janë të punësuar në sektorin privat, krahasuar vetëm 7.6 për qind në sektorin publik. 13.5 për qind nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që kanë gjetur punë. Aplikimet e drejtpërdrejta tek punëdhënësit, agjencitë private të punësimit dhe mënyrat e tjera të gjetjes së

një pune janë paraqitur në një nivel shumë më të ulët.

Papunësia është shumë e shpërndarë, veçanërisht në mesin e femrave që duket se janë më pasive në kërkimin e punës se sa meshkujt. Rezultatet e tyre ishin më të ulëta në të gjitha kategoritë/kanalet e kërkimit për punë.

Kur është fjala për llojin e preferuar të punës, femrat janë më të prirura për të kërkuar punë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, ndërkohë që meshkujt, përveç punës me orar të plotë, zgjedhja e tyre e preferuar është vetëpunësimi.

Ka një mungesë të interesimit dhe besimit nga ana e të anketuarve në përdorimin e kanaleve zyrtare të komunikimit.

Ka një perceptim të madh se njohja e njerëzve është një parakusht i përgjithshëm për marrjen e një pune si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik në Kosovë, pavarësisht faktit se vetëm 2.9 për qind e të punësuarve që kanë marrë pjesë në anketë kanë raportuar gjetjen e punës me ndihmë nga miqtë apo familja.

Trajnimet në Qendrat për Aftësim Profesional u raportuan se janë ndjekur nga 10.4 për qind e të anketuarve në mostër. Kjo përqindje duhet të jetë dukshëm më e madhe, duke marrë parasysh numrin e të anketuarve që thanë se ishin të papunë.

Në lidhje me nivelet e pritura të pagave, ato janë mjaft të ulëta dhe 8.9 për qind e të anketuarve janë të gatshëm për të punuar për një pagë deri në 200 euro/muaj, ndërsa

rreth 3 për qind do të punonin për më pak se 150 euro. 13.7 për qind e të anketuarve ishin të gatshëm të punojnë për një pagë prej 200-250 euro në muaj. Megjithatë, disa të anketuar kanë deklaruar se pritjet e tyre për pagë janë mbi 500 euro në muaj. Këta të anketuar e kanë përvojën ose nivelin më të lartë të kualifikimit.

### **Rekomandimet kryesore**

Nga konkluzionet e nxjerra më lartë, rekomandimet për akterët kyç janë:

#### **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS):**

Ministria duhet të ndërmarrë masa për të promovuar punësimin, në mënyrë të veçantë atë të femrave, ku shkalla e papunësisë është tronditëse. Planifikimi i projekteve për zbutjen e papunësisë gjithnjë duke pasur parasysh edhe emancipimin e gjinisë femërore janë thelbësore .

Ministria duhet të investojë në fuqizimin e Inspektoratit të Punës dhe të instalojë mekanizma të llogaridhënies për monitorimin e performancës së tyre. Zgjerimi i të drejtave të inspektimit lidhur me ligjet për punë është një mundësi për përmirësimin e efikasitetit të zbatimit të legjislacionit lidhur me punën dhe për luftimin e informalitetit.

Ministria duhet të bëhet partner i sektorit privat dhe komunave për të identifikuar së bashku kërkesën për punë në mënyrë që të gjenerohen përgjigje të duhura për të lehtësuar koordinimin në mes të ofertës dhe kërkesës për punë. Strategjia Kombëtare për Zhvillim duhet të përfshijë masa të drejtpërdrejta të cilat trajtojnë mungesën e aftësive në tregun e punës dhe lehtësojnë

krijimin e punëve. Për këtë qëllim, zhvillimi i programeve të trajnimit për profesione të ndryshme, që punësojnë femrat është i një rëndësie të veçantë.

Masat alternative për të trajtuar çështjet që parandalojnë femrat që të angazhohen në tregun e punës, si mungesa e kopshteve në shumë qytete të Kosovës, po ashtu duhet të merren parasysh. Financimi i iniciativave të tilla në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe komunave i bën këto masa tërheqëse pasi që përgjegjësia e financimit nuk do të jetë tërësisht e MPMS-së. Ngritja e vetëdijes për të aplikuar për pozita të cilat janë të reklamuar për të ngritur institucionin e konkurrencës së hapur, duhet po ashtu të jetë prioritet për ministrin. Rëndësia e kërkimit aktiv për punë duhet të promovohet tek punëkërkuesit si një hap i rëndësishëm për koordinimin mes kërkesës dhe ofertës. Kultura e nepotizmit po ashtu duhet të luftohet përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe kështu punësimi i drejtë duhet të promovohet si opsioni më i mirë për sektorët privat dhe publik.

Paga minimale me orarë të plotë duhet të vendoset 200 euro në muaj, pasi që gatishmëria për të punuar për më pak se 200 euro është shumë e ulët (më pak se 3 për qind) nga të papunët. Kjo pagë minimale do të ofronte hapësirë të mjaftueshme për punëdhënësit të bëjnë dallimin në mes të niveleve të aftësive, përvojës brenda kufijve të përballueshmërisë si dhe ruajtjen e konkurrencës në aspektin e shpenzimeve të punës.



### **Këshilli Ekonomik Social (KES):**

KES duhet të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që të ndajë burimet e nevojshme për të siguruar implementimin e duhur të legjislacionit lidhur me punën dhe fuqizimin e institucioneve përkatëse në luftimin e informalitetit në tregun e punës.

KES duhet ti rekomandojë Qeverisë së Kosovës që paga minimale për punë me orar të plotë të jetë 200 euro në muaj si minimum i nevojshëm për mbijetesë në Kosovë dhe si një nivel minimal i pagës.

### **Përfaqësuesit e punëdhënësve:**

Të marrin rol aktiv në promovimin e formalizimit të praktikave të biznesit dhe ngritjen e vetëdijes së ndërmarrjeve për rëndësinë e pajtueshmërisë me legjislacionin ekzistues. Për këtë qëllim, partneritetet ndër sektoriale duhet të krijohen brenda Qeverisë për të kontribuar së bashku në formalizimin e ekonomisë dhe tregut të punës.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit, si përfaqësuese të punëdhënësve në Këshillin Ekonomik Social duhet të angazhohen në diskutime të gjera me antarët e tyre para se të pajtohen me sindikatat.

### **Sindikatat:**

Sindikatat duhet të vazhdojnë angazhimin aktiv dhe avokimin për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore mbi temat e dialogut social. Për këtë qëllim, monitorimi në terren i zbatimit të ligjit është funksioni themelor për sindikatat, jo vetëm për ata që janë në KES, por edhe për ata jashtë KES-it.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, si një përfaqësues i vetëm i punëtorëve në KES, duhet të vazhdojë reformën e nisur dhe ristrukturimin e brendshëm që të jetë në gjendje të zgjeroj praninë e saj në sektorin privat në mënyrë më efektive. Po ashtu, duhet të miratojë një qasje më pro aktive për të zbatuar rekomandimet e saj në diskutime dhe debate publike për çështjet lidhur me punën. Komunikimi aktiv i dyanshëm duhet të ndërtohet në përputhje me rekomandimet e anëtarësisë së tyre.



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:

